



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 17.08.2023
02 Nr.400/01-21432/23

PROCESVERBAL

Dëgjimi Buxhetor në Brodosanë, me banorët e fshatrave Zaplluxhe, Blaç, Brodosanë, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre I mbajtur më 17.08.2023, e enjte, duke filluar nga ora 18:00
VENDI: ShFMU "28 Nëntori" - Brodosanë

Njoftimi për këtë Dëgjim Buxhetor është publikuar:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës më 12.08.2023:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Brodosane.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Brodosane.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 12.08.2023:

Shqip: <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=637941415101712&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=637952018433985&set=pb.100066575766996.-2207520000>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Resul Fetahu – Nënkyetar
3. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
6. Vetim Ramadani – Drejtor i Administratës
7. Veton Halili – Shef i Kabinetit
8. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor kanë qenë gjithsej 45 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 2
2. Meshkuj: 43

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! E vlerësoj prezencën tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Është obligimi ynë si ekzekutiv që ta prezantojmë para jush projekt-buxhetin për vitin 2024, ndërsa prezenca juaj këtu është përmbushje e një obligimi moral e qytetar. Këtë vit buxheti është më i madh se vitin e kaluar. Pas këtyre dëgjimeve buxhetore, ku do t'i marrim kërkesat dhe sugjerimet e juaja, në shtator do ta finalizojmë draft-buxhetin dhe do t'ia paraqesim Asamblesë Komunale për miratim. Pjesa më e rëndësishme e buxhetit për ne është ajo e investimeve kapitale. Këtë vit do të kemi më pak ndarje buxhetore nëpër fshatrave, për shkak se shumica e buxhetit do të destinohet për projektin e Ujësjellësit kryesor, dhe një pjesë tjetër për ndërtimin e fabrikës së ujit.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim prezanton para të pranishmëve Listën preliminare të shpenzimeve kapitale të parapara për vitin 2024.

Kërkesat e qytetarëve

Driton Ademi, asambleist i Kuvendit Komunal në Dragash:

- Është një kërkesë, te shpia e Shabanit nalt te të Bajram Donës, një ujë vjen poshtë nëpër rrugë, një mur me e bo. Është mirë me i pyet ata, se nuk e di sa metër është ai muri, ose sa bëhet.

Halit Reshiti, banor i fshatit Brodosanë:

- Shtëpia e Shëndetit është në gjendje të mjerë. A do të investohet diçka?

Miran Mustafa, banor i fshatit Brodosanë:

- Kërkoj të bëhet trasimi i rrugës "Ndërlivadhët"

Idriza Qusaj, banor i fshatit Pllajnik:

- Në fshatin Pllajnik janë disa rrugë ku duhet të intervenohet, ku duhet të ndërtohen edhe disa mure mbrojtëse dhet të bëhet hapja e rrugës fushore Kodër-Cylen-Bogdonicë. Ju kisha lut që të shfrytëzoni burimet kapitale dhe të na ndihmoni me pak më shumë mjete për fshatin Pllajnik

Kapllan Fetahu, banor i fshatit Kuk:

- Desha të ju rikujtoj kërkesën që e kam bërë në Takimin e parë publik me qytetarë. Është fjala për rrugën Kosavë – Kuk ose anasjelltas, e cila duhet të bëhet.
- Pastaj duhet një investim në Ambulantën e fshatit Kuk, sidomos të rrethojat e objektit, sepse është në gjendje të keqe. Gjendja në Ambulantën e Kukit është ndër prioritetet kryesore për fshatin.

Betim Opoja, banor i fshatit Brodosanë:

- Për Shtëpinë Malore në Bresanë, do të ishte më serioze të çohet edhe rryma atje, sepse nëse nuk kemi rrymë, nuk na duhet edhe Shtëpia Malore.

Sefidin Mejini, asambleist i Kuvendit Komunal në Dragash:

- Në fshatin Kosavë e kemi një kanalizim që është jofunksional, duhet të intervenohet sepse kundërmon erë të keqe.
- Rruga ekzistuese e asfaltuar nëpër fshat duhet të riparohet.
- Mungon një stadium për futboll të vogël në fshatin Kosavë.
- Prioritet është edhe ndriçimi publik i fshatit.

Hatnan Zejnullahu, banor i fshatit Brodosanë:

- Propozoj të shtrohet me kubëza rruga të varrezat, është një rrugë e shkurtë.

Vedat Avdiu, banor i fshatit Zaplluxhe:

- Është një shqetësim për Bjeshkën e Zaplluxhës. Vazhdimisht po bëhen ndërtime. A do të ketë ndonjë plan konkret nga Komuna për ndërtimet që po bëhen në zonën turistike në këtë bjeshkë?

Arben Zyberi, banor i fshatit Buzez:

- Fshati Buzez kemi një problem me ujin. A ka mundësi Komuna me na lidhë me gypat e Ujësjellësit kryesor?
- Kërkojmë të bëhet ndriçimi publik për fshatin Buzez.

Visar Veseli, Banor i fshatit Brodosanë:

- Kërkoj të bëhet mbledhja e ujrave në rrugën Bresanë-Zgatar, kur të bëhet kubëzimi i kësaj rruge.

Lista e nënshkrimeve e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë

LISTA E PJESMARRËSVE

Fshati: BRODOSANË

Data: 17.08.2023

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	ARTAN XHELADINI	BRESANË	[Signature]
2	GURSEL MYRTEZANI	ZAPLLUXHË	[Signature]
3	HAJDIR DORRIZI	BRESANË	[Signature]
4	Arben Ahmeti	Bresanë	[Signature]
5	Vedat Ardiu	Bresanë	[Signature]
6	Mirë Myrtezani	Zaplluxhë	[Signature]
7	Sehidin Mehmeti	Kobovë	[Signature]
8	BEHDIN GURAJ	KOSOVË	[Signature]
9	Ergin Hasani	Bresan	[Signature]
10	Idmir Zeynullahi	Blac	[Signature]
11	BEHZAD ROKIPI	Bresanë	[Signature]
12	EMIR JUSUF	BLAC	[Signature]
13	Abdylajim ACILI	BRESAN	[Signature]
14	Visar Veseli	Bresanë	[Signature]
15	BETIM OPOJA	Bresanë	[Signature]
16	Parim Ahmeti	KUK	[Signature]
17	KELM LATIFI	BLAC	[Signature]
18	Behar Zambari	Brocos	[Signature]
19	HALIT RESHITI	BRODOSANË	[Signature]
20	ARBEN ZYBERI	BUREZ	[Signature]
21	Zamir Ahmeti	BUREZ	[Signature]
22	Abdullahu Zambari	BUREZ	[Signature]
23	Vedat Ardiu	Zaplluxhë	[Signature]
24	Dreni Myrtezani	Zaplluxhë	[Signature]
25	VEFIR RESHITI	MIRAN	[Signature]
26	Najir Selmani	Bresan	[Signature]
27	Miran Mustafa	Bresanë	[Signature]
28	Samidin Xheladini	Brocosanë	[Signature]
29	Matiu Zeynullahu	Bresanë	[Signature]
30	Xhuferr Balidgari - Begim	Bresanë	[Signature]
31	BEZIR BEZIRI	BRESANË	[Signature]
32	MYSFIR SALIHU	BRESAN	[Signature]
33	Abaz Bengaj	Blajnik	[Signature]
34	Driton Ahmeti	Bresanë	[Signature]
35	Idrit Selmy	KUK	[Signature]
36	Amal Samadani	KUK	[Signature]
37	Kapllan Fetahu	KUK	[Signature]
38	Basri Shasiuari	Bresanë	[Signature]
39	Imam Selmy	KOSOVË	[Signature]
40	HABIB AHMEDI	KUK	[Signature]

Idriz Guraj

Plojuok

[Signature]

